



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 726 Akti

Nr. 771 Vendim  
Tiranë, më 5.6.2024

**V E N D I M**

Trupi gjykues nr. 2 i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Alma Faskaj</b>	Kryesuese
<b>Valbona Sanxhaktari</b>	Relatore
<b>Pamela Qirko</b>	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Mevi Dibra, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Elka Ermenkova, në datën 4.6.2024, ora 13:00, zhvilloi në Pallatin e Koncerteve, salla B, kati 0 (*underground*), në Tiranë, seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Znj. Ariana Gaçi**, me detyrë ndihmëse ligjore në Gjykatën e Lartë, e pranishme në seancën dëgjimore.

**OBJEKTI:** Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

**BAZA LIGJORE:** Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2012**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

**TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, komisioneres Valbona Sanxhaktari, dëgjoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në seancë dëgjimore, analizoi provat shpresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

**I. RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1. Znj. Ariana Gaçi i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 4 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 1 të nenit 165 të ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar, si dhe pikës 16 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, për shkak të funksionit të saj si ndihmëse/

këshilltare ligjore në Gjykatën e Lartë, prej datës 7.4.2014 deri më 13.10.2017. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, si dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) ka hedhur shortin në datën 15.6.2021, nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 1, me përbërje si më lart në këtë vendim.

**2.** Me vendimin nr. 1, datë 21.6.2021, është vendosur kryesuese komisionere Alma Faskaj, është deklaruar lidhur me konfliktin e interesit nga të gjithë anëtarët e trupit gjykues, si dhe fillimi i hetimit administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit.

**3.** Në vijim, subjekti i rivlerësimit është njoftuar mbi përbërjen e trupit gjykues dhe ka deklaruar se nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues.

**4.** Nga relatorja e çështjes, bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, janë administruar raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI), Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ). Gjatë hetimit administrativ është komunikuar nëpërmjet komunikimit elektronik me subjektin e rivlerësimit, ku iu dërgua pyetësori i përgatitur nga Komisioni, si dhe pyetje të tjera në vijim gjatë hetimit administrativ, të cilat u administruan në dosje.

**5.** Trupi gjykues, i mbledhur në datën 21.5.2024, ora 12:00, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, u njoh me raportin mbi rezultatet e hetimit dhe rekomandimin e relatores së çështjes e, në vijim, pas diskutimeve, me vendimin nr. 2 vendosi: (a) përfundimin e hetimit administrativ për subjektin e rivlerësimit Ariana Gaçi, bazuar në të tria kriteret e rivlerësimit; (b) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit dhe ta ftojë atë për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, nenet 35-40 dhe 45-47 të Kodit të Procedurave Administrative; (c) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji për të kërkuar marrjen e provave të tjera, thirrjen e dëshmitarit, afatin brenda të cilit mund t’i ushtrojë këto të drejta, si dhe të paraqesë parashtrimet e tij lidhur me rezultatet e hetimit.

**6.** Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e administruara në dosjen e hetimit, duke marrë një kopje të saj. Në vijim, brenda afatit të caktuar nga Komisioni paraqiti shpjegime dhe prova lidhur me rezultatet e hetimit.

**7.** Më tej, trupi gjykues, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, me vendimin nr. 3, datë 29.5.2024, vendosi ta ftojë subjektin e rivlerësimit Ariana Gaçi për t’u paraqitur në seancë dëgjimore në datën 4.6.2024, ora 13:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0.

**8.** Seanca dëgjimore u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 4.6.2024, ora 13:00, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Elka Ermenkova.

**9.** Subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht në këtë seancë dëgjimore publike, gjatë së cilës parashtrori qëndrimin lidhur me rezultatet e hetimit, në përfundim të së cilës kërkoi konfirmimin e saj në detyrë.

**10.** Trupi gjykues përfundoi seancën dëgjimore dhe, për rrjedhojë, edhe procesin e rivlerësimit për znj. Ariana Gaçi në seancën e datës 4.6.2024, seancë në të cilën subjekti i rivlerësimit ishte i pranishëm.

## II. PROCESI I RIVLERËSIMIT

**11.** Procesi i rivlerësimit, i cili kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Anëtarët e Komisionit hetojnë dhe vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit. Ata kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo *indicie* në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes.

**12.** Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja dhe provat e dorëzuara nga subjekti pranë këtij institucioni në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*;
- b) raportin e dorëzuar në Komision nga AKSIK-ja, së bashku me dokumentacionin shoqëruar;
- c) raportin e dorëzuar në Komision nga KLGJ-ja, së bashku me materialin shoqëruar;
- ç) dokumentet shkrese nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- d) deklaratimet nga subjekti i rivlerësimit nëpërmjet komunikimit elektronik;
- dh) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të paraqitura në përfundim të hetimit kryesisht;
- e) denoncimet nga publiku;
- ë) informacionin nga burime të hapura.

**13.** Lidhur me qëndrimin e subjektit të rivlerësimit Ariana Gaçi, trupi gjykues vëren se ajo ka qenë bashkëpunuese gjatë procesit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ subjekti Ariana Gaçi ka komunikuar me Komisionin në mënyrë korrekte dhe brenda afateve të përcaktuara.

### A. VLERËSIMI I PASURISË

**14.** Subjekti i deklaratimit ka dorëzuar deklaratën e pasurisë për procesin e rivlerësimit pranë ILDKPKI-së, së bashku me dokumentacionin provues. Kjo deklaratë, në bazë të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, iu nënshtua hetimit administrativ nga ILDKPKI-ja, i cili dërgoi raportin e tij lidhur me këtë vlerësim.

**15.** Në vijim, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, pavarësisht nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse<sup>2</sup>, duke verifikuar deklaratën e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Ariana Gaçi.

**16.** Në deklaratën e pasurisë për procesin e rivlerësimit, pas verifikimit administrativ të kryer nga Komisioni, ka rezultuar si vijon:

**17. Pasuria apartament me sip. 74 m<sup>2</sup>**, z. k. \*\*\*, nr. pasurie \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë, bashkëpronare në ¼ pjesë, nëpërmjet trashëgimisë nga i ati.

**17.1** Komisioni hetoi lidhur me pasurinë e deklaruar, ku nga verifikimi i dokumentacionit të administruar nga ASHK-ja, rezultoi se<sup>1</sup>:

a) Pasuria është përfituar nga shtetasi XH.K, babai i subjektit të rivlerësimit, sipas Kontratës datë 16.4.1993. Në vijim, sipas vendimit nr. \*\*\* akti dhe nr. \*\*\* vendimi, datë 14.10.2008, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është lëshuar dëshmia e trashëgimisë ligjore për të ndjerin, shtetasin Xh.K, duke përcaktuar trashëgimtarët ligjorë të tij, të cilët kanë trashëguar

<sup>1</sup> Shihni shkresat nr. \*\*\* prot., datë 6.2.2024 dhe nr. \*\*\* prot., datë 25.3.2024, në dosjen e hetimit.

nga ¼ pjesë secili të pasurisë së trashëgimlënësit. Pasuria nr. \*\*\*, prej 74 m<sup>2</sup>, është regjistruar në emër të trashëgimtarëve ligjorë sipas Certifikatës së Pronësisë nr. \*\*\*, datë 17.12.2008.

b) Sipas Kontratës së Dhurimit nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 15.8.2019, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj, në cilësinë e palës dhuruese, kanë dhuruar pjesën takuese prej ¼ të pasurisë apartament me sip. 74 m<sup>2</sup>, pa asnjë kundërshpërblim, detyrim, kusht apo barrë, tre pranuesve të dhurimit, nënës së subjektit të rivlerësimit dhe dy vëllezërve.

c) Pasuria apartament me sip. 74 m<sup>2</sup>, nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, është regjistruar në emër të shtetasve Q.K, L.K dhe L.K, në datën 23.8.2019, sipas Kartelës së Pasurisë së Paluajtshme dhe Certifikatës së Pronësisë nr. \*\*\*, datë 23.8.2019.

**17.2** Në përfundim, trupi gjykues nuk ka konstatuar problematika për këtë pasuri në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar.

**18. Pasuria apartament me sip. 58 m<sup>2</sup>**, nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, në rrugën “\*\*\*\*”, p. \*\*\*, shk. \*\*\*, ap. \*\*\*, Tiranë, fituar nëpërmjet privatizimit të banesës shtetërore, sipas Certifikatës së gjendjes Familjare në datën 1.8.1991. Pjesa takuese: ¼ pjesë e totalit.

**18.1** Komisioni hetoi lidhur me pasurinë e deklaruar si më sipër dhe nga verifikimi i dokumentacionit të administruar nga ASHK-ja rezultoi se<sup>2</sup>:

a) Pasuria apartament me sip. 58 m<sup>2</sup>, me vendndodhje në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë, pallati nr. \*\*\*, kati \*\*\*, ishte në pronësi të Ndërmarrjes Komunale Banesa nr. \*\*\*. Sipas Certifikatës Familjare datë 22.9.2016, rezulton se përbërja familjare në datën 1.8.1991 ka qenë me kryefamiljar shtetasin Xh.K, Q.K (bashkëshortja), L.K, A.K e L.K (fëmijët e tyre). Në vijim, mes palëve Ndërmarrja Komunale Banesa Nr. \*\*\*, në cilësinë e shitësit, dhe shtetasve Xh.K, Q.K, L.K e A.K, në cilësinë e blerësit, është nënshkruar kontratë shitjeje, jashtë zyrës noteriale, me çmim shitjeje të pasurisë 3.291 (tre mijë e dyqind e nëntëdhjetë e një) lekë, likuiduar sipas mandatarëkëtimit nr. \*\*\*, datë 30.12.1993. Kontrata e shitjes është vërtetuar para noterit, sipas vërtetimit nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 17.6.1994.

b) Në datën 4.8.1994 është nënshkruar Kontrata e Dhurimit nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., ku shtetasi Xh.K, në cilësinë e dhuruesit, i ka dhuruar shtetasen Q.K (bashkëshortja), pa kundërshpërblim, apartamentin 1+1, që ndodhet në pallatin nr. \*\*\*, rruga “\*\*\*\*”, kati \*\*\*. Referuar dokumentacionit të administruar<sup>3</sup>, sipas kartelës së pasurisë së paluajtshme rezulton se pasuria apartament me sip. 58 m<sup>2</sup>, rruga “\*\*\*\*”, është regjistruar në ZVRPP Tiranë në datën 21.7.2013, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, në regjistrin me të dhëna kadastrale z. k. \*\*\*, nr. pasurie \*\*\*, në pronësi të shtetasve A.K, L.K e Q.K.

**18.2** Në përfundim, trupi gjykues nuk ka konstatuar problematika për këtë pasuri në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar.

**19. Apartament garsoniere me sip. 45 m<sup>2</sup>, në Rrugën \*\*\*, \*\*\*, kulla \*\*\*, nr. \*\*\*, Tiranë.** Vlera 34.000 (tridhjetë e katër mijë) euro, blerë në bashkëpronësi P.G 17.000 (shtatëmbëdhjetë mijë) euro (bashkëshorti) dhe E.G 17.000 (shtatëmbëdhjetë mijë) euro. Bashkëshorti P.G zotëron ½ pjesë. Pjesa takuese: 25% (1/4 pjesë e totalit).

**19.1** Komisioni hetoi për pasuri në pronësi të subjektit të rivlerësimit apo personave të lidhur, por nga ASHK-ja nuk është përcjellë në Komision informacion lidhur me këtë pasuri.

a) Referuar dokumentacionit të administruar në dosjen e hetimit administrativ rezulton se në datën 1.4.2010, mes palës shitëse shoqëria e ndërtimit “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe palës blerëse P.G dhe E.G është nënshkruar Kontrata e Shitjes së Pasurisë së Paluajtshme me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., për pasurinë apartament nr. \*\*\*, me sip. 45 m<sup>2</sup> (5 m<sup>2</sup> sipërfaqe në bashkëpronësi), në total 50 m<sup>2</sup>, kati \*\*\*, kulla \*\*\*, me adresë Rruga \*\*\*. Pasuria është shitur kundrejt çmimit 34.000

<sup>2</sup> Shihni Aneksin 4/2, dosja e ILDKPKI-së dhe shkresat nr. \*\*\* prot., datë 6.2.2024 dhe nr. \*\*\* prot., datë 25.3.2024, në dosjen e hetimit.

<sup>3</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 30.3.2018, të ZVRPP Tiranë, Aneks 28, dosja e ILDKPKI-së.

(tridhjetë e katër mijë) euro, likuiduar në favor të shitësit jashtë zyrës noteriale, me këste, sipas Kontratës së Sipërmarrjes datë 31.3.2007.

**b)** Referuar kartelës së pasurisë, rezulton se apartamenti është regjistruar në regjistrin kadastral në datën 16.4.2010, z. k. \*\*\*, nr. pasurie \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, në bashkëpronësi të shtetasve P.G dhe E.G.

**19.2** Lidhur me çmimin e blerjes së apartamentit, referuar të dhënave të tregut të lirë për qytetin e Tiranës<sup>4</sup>, nuk rezulton që pasuria të jetë blerë me një çmim preferencial<sup>5</sup>.

**19.3** Në lidhje me burimin e krijimit subjekti ka sqaruar se burimi i krijimit të kësaj pasurie, krijuar para detyrës (pjesa takuese), janë kursimet e realizuara nga puna ndër vite, duke bashkëlidhur dokumentacion provues për punësimin e saj dhe të bashkëshortit, të cilat janë përfshirë në analizën financiare.

**19.4** Në analizën financiare nuk janë konsideruar:

- Të ardhurat e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit P.G për periudhën nëntor 2003 – korrik 2005, të deklaruara si të përfituara nga punësimi, pranë studios ligjore “\*\*\*\*” sh.p.k., duke qenë se mungojnë të dhënat e deklarimeve tatimore në bazë të ligjit nr. 84/2016 dhe nuk është provuar ligjshmëria e tyre;
- Të ardhurat e subjektit të rivlerësimit nga kontrata e shërbimit dhe bashkëpunimit me \*\*\*, për periudhën korrik – shtator 2008, pasi dokumentacioni provues i përcjellë nga subjekti i rivlerësimit rezultoi të mos jetë depozituar në formën e kërkuar, duke mos i konsideruar si prova të mjaftueshme të evidentimit të pagesave dhe shpërblimeve të marra.

**19.5** Nga analiza financiare e Komisionit rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë pasur mundësi financiare për krijimin e pasurisë.

**19.6** Trupi gjykues vlerëson se pasuria është krijuar para fillimit të detyrës nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të (periudha 2007 – 2010) e, gjithashtu, me burime financiare të mjaftueshme. Për këtë pasuri nuk kanë rezultuar problematika.

**20 Automjet tip “Ford Mondeo” 4+1**, vit prodhimi 2005, me targë AA \*\*\* FP, blerë nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, z. P.G, me të ardhura nga veprimtaria tregtare si person fizik; regjistruar në DPSHTRR Tiranë më 14.1.2013. Vlera: 2.000 (dy mijë) euro.

**20.1** DPSHTRR-ja informon<sup>6</sup> se nga verifikimet e kryera ka rezultuar se në emër të z. P.L.G është i regjistruar mjeti me targë AA \*\*\* VV. Nga verifikimi i dokumentacionit të mjetit rezulton se është i njëjti mjet që më parë ishte i pajisur me targën AA \*\*\* FP, më pas me targën AA \*\*\* TT (datë 3.4.2018) dhe aktualisht nga data 25.9.2018 mban targën AA \*\*\* VV.

**20.2** Referuar dosjes së regjistrimit të automjetit tip “Ford Mondeo”, nr. shasie \*\*\*, rezulton se sipas Deklaratës Doganore nr. \*\*\*, datë 11.1.2013, automjeti ka vlerën 2.000 (dy mijë) euro, me kurs këmbimi 139.590, si dhe janë paguar detyrimet doganore në vlerën 104.803 (njëqind e katër mijë e tetëqind e tre) lekë, në total 279.285 (dyqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e tetëdhjetë e pesë) lekë.

**20.3** Blerja e automjetit është realizuar sipas Kontratës së Shitblerjes datë 7.1.2013, me palë shitëse shtetasin e huaj (gjerman) A.V dhe palë blerëse shtetasin P.G, me çmim të kontratës 2.000 (dy mijë) euro. Automjeti është regjistruar me targë AA \*\*\* FP, në datën 14.1.2013, në emër të z. P.G.

**20.4** Nga verifikimi në sistemin elektronik të AMF-së rezulton se polica e fundit TPL për këtë mjet mban datat 18.1.2018 – 26.1.2019.

<sup>4</sup> Udhëzimi i Këshillit të Ministrave nr. 3, datë 3.2.2010, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2010”.

<sup>5</sup> Analiza i referohet zonës \*\*\* të qytetit të Tiranës, ku ndodhet pasuria, e cila në vitin 2010 kishte një çmim tregu prej 87.500 lekë/m<sup>2</sup>. Kështu për 45 m<sup>2</sup> vlera llogaritet 3.937.500 lekë. Kursi i këmbimit të valutës euro në vitin 2010 ka qenë 138,81. Vlera prej 34.000 euro i korrespondon vlerës 4.719.540 lekë).

<sup>6</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 20.2.2024, në dosjen e hetimit.

**20.5** Nga analiza financiare e Komisionit rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë qenë në pamundësi financiare, së paku sa vlera e pasurisë automjet, në shumën -280.420 (dyqind e tetëdhjetë mijë e katërqind e njëzet) lekë, për krijimin e kësaj pasurie në vitin 2013.

**20.6** Në këto kushte, nisur nga deklaratimet e subjektit të rivlerësimit për burimin e krijimit të kësaj pasurie, Komisioni vlerësoi se nëse në analizë do të konsideroheshin vetëm të ardhurat nga aktiviteti i bashkëshortit si avokat<sup>7</sup> dhe si person fizik "P.G"<sup>8</sup>, ai rezultonte në pamundësi financiare për krijimin e kësaj pasurie, sipas burimit të deklaruar të krijimit, duke qenë se janë krijuar edhe pasuri të tjera përkatësisht: apartament garsoniere në vitin 2010 dhe likuiditet cash me kursimet deri në vitin 2012.

**20.7** Në vijim të konstatimit të Komisionit gjatë hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit me prapësimet dhe shpjegimet e saj, të shoqëruara me dokumentacion provues,<sup>9</sup> sqaron: *"Nga dokumentacioni i paraqitur në vijim të rezultateve të hetimit rezulton se të ardhurat financiare i shtohen analizës financiare që hetimi administrativ ka realizuar 630 euro (700 euro minus 10%) + 810 (900 euro minus 10%) me kursin e këmbimit të Bankës së Shqipërisë 140,0 (viti 2012), e cila ka qenë në periudhën kohore në shumën totale 216.000 (dyqind e gjashtëmbëdhjetë mijë) lekë. Në lidhje me dokumentacionin mbi të ardhurat e bashkëshortit për periudhën nëntor 2003 – korrik 2005, të deklaruara si të përfituara nga punësimi pranë studios ligjore "\*\*\*\*", sjell si provë në formën e duhur ligjore vërtetimin nga partneri A.Ç i studios ligjore "\*\*\*\*", me NIPT \*\*\*. Sipas këtij vërtetimi se bashkëshorti im, personi i lidhur P.G, ka qenë i punësuar si avokat në periudhën 1.11.2003 – 31.7.2005 dhe ka përfitur të ardhura bruto nga paga, në total 241.172 (dyqind e dyzet e njëmijë e njëqind e shtatëdhjetë e dy) lekë, ndërsa neto, duke zbritur kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore ka përfitur 188.456 (njëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e katërqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekë neto. Pra, duke mbledhur shumën neto të përfitur nga unë, subjekti i rivlerësimit Ariana Gaçi, së bashku me kontratat e mësipërme 216.000 (dyqind e gjashtëmbëdhjetë mijë) lekë + 188.456 (njëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e katërqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekë të bashkëshortit, rezulton totali në shumën 404.456 (katërqind e katër mijë e katërqind e pesëdhjetë e gjashtë) të ardhura. Këto janë të ardhura që i shtohen rezultatit të analizës financiare, të cilat nuk janë konsideruar nga ana e Komisionit, për shkak të mangësive të mësipërme".*

**20.8** Trupi gjykues, pasi vlerësoi qëndrimin e subjektit së bashku me dokumentacionin e paraqitur prej tij në cilësinë e provave, në raport edhe me dokumentacionin e administruar gjatë hetimit administrativ, pas analizës së kryer vlerëson se pasi janë marrë në konsideratë të ardhurat e pretenduara të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur, bashkëshortit, ata rezultojnë në pamundësi financiare në shumën -131.093 (njëqind e tridhjetë e një mijë e nëntëdhjetë e tre) lekë, për krijimin e pasurisë automjet, që rezulton e blerë në janar të vitit 2013 para ushtrimit prej saj të funksionit të ndihmësës ligjore.

**20.9** Në përfundim, trupi gjykues çmon se kjo situatë negative është irrilevante në një vlerësim proporcional dhe objektiv të kryer në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin Ariana Gaçi.

**21 Shuma cash 10.000 (dhjetë mijë) euro**, pjesa takuese 50% (1/2 pjesë e totalit). Kjo shumë cash është krijuar nga kursimet e krijuara nga të ardhurat nga puna e subjektit gjatë veprimtarisë në profesionin e juristes, që datojnë nga viti 1995 e në vazhdim dhe e bashkëshortit avokat, me NIPT \*\*\*, licencë nr. \*\*\*\* të Dhomës së Avokatëve Tiranë, në bashkëpronësi bashkëshortore.

**21.1** Nga hetimi i kryer nga Komisioni rezulton se në Deklaratën *Vetting* subjekti i rivlerësimit deklaroi shumën cash 10.000 (dhjetë mijë) euro, të krijuar nga kursimet nga të ardhurat nga

<sup>7</sup> Të ardhurat nga aktiviteti si avokat për periudhën 1994 – 1998 janë në shumën 451.600 lekë.

<sup>8</sup> Të ardhurat nga aktiviteti si PF P.G me NIPT \*\*\*, regjistruar në datën 6.6.2007 për periudhën 2008 – 2012 janë në shumën 1.186.598 lekë.

<sup>9</sup> Kontratë bashkëpunimi me \*\*\* për periudhën korrik – shtator 2008, kontratë bashkëpunimi me \*\*\* datat 21.12.2012 dhe 1.10.2013, i sjell si prova në formën e duhur ligjore, të përkthyer dhe të noterizuara.

puna e subjektit të rivlerësimit që nga viti 1995 e në vijim dhe nga të ardhurat e bashkëshortit avokat me NIPT \*\*\*, në bashkëpronësi bashkëshortore dhe pjesë takuese 50% (pjesë e totalit).

**21.2** Nga analiza financiare e Komisionit, duke konsideruar të ardhurat deri në vitin 2012, rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti ishin në pamundësi financiare -180.844 (njëqind e tetëdhjetë mijë e tetëqind e dyzet e katër) lekë për krijimin e likuiditetit *cash* të deklaruar në vitin 2014 në shumën 20.000 (njëzet mijë) euro.

**21.3** Në vijim të konstatimit nga Komisioni, gjatë hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit me shpjegimet e saj sqaron se: *“Nëse të ardhurat e saj prej 216.000 (dyqind e gjashtëmbëdhjetë mijë) lekësh + 188.456 (njëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e katërqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekësh të bashkëshortit, në total në shumën 404.456 (katërqind e katër mijë e katërqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekë, të cilat nuk janë konsideruar nga ana e Komisionit, i shtohen rezultatit të analizës financiare, sipas dokumentacionit të paraqitur, nuk rezulton në pamundësi financiare për krijimin e likuiditetit të deklaruar”*.

**21.4** Trupi gjykues, pasi vlerësoi shpjegimet e subjektit së bashku me dokumentacionin e paraqitur prej tij në cilësinë e provave, në raport edhe me dokumentacionin e administruar gjatë hetimit administrativ, pas analizës së kryer çmon se dokumentacioni i paraqitur shtesë duhet pranuar e, në vijim, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, bashkëshorti, ka pasur mundësi financiare për krijimin e pasurisë me burime të ligjshme.

**22. Llogari rrjedhëse në Credins Bank**, në emër të znj. Ariana Gaçi, në lekë, nr. \*\*\*, në vlerën 345,39 (treqind e dyzet e pesë lekë e tridhjetë e nëntë të qindtat) lekë. Pjesë takuese: 100%.

**23. Llogari rrjedhëse në Credins Bank**, në emër të z. P.G, në lekë, nr. \*\*\*, në vlerën 27.785 (njëzet e shtatë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e pesë) lekë. Pjesë takuese: 100%.

**24. Llogari rrjedhëse në Credins Bank**, në emër të z. P.G, në lekë, nr. \*\*\*, në vlerën 61.000 (gjashtëdhjetë e një mijë) lekë. Pjesë takuese: 100%.

**25. Llogari rrjedhëse në Credins Bank**, në emër të z. P.G, në dollar, nr. \*\*\*, në vlerën 54,92 (pesëdhjetë e katër e nëntëdhjetë e dy të qindtat) USD. Pjesë takuese: 100%.

**26. Llogari rrjedhëse në Credins Bank**, në emër të z. P.G, në euro, nr. \*\*\*, në vlerën 17 (shtatëmbëdhjetë) euro. Pjesë takuese: 100%.

**27.** Trupi gjykues nuk ka konstatuar problematika lidhur me këto pasuri, bazuar në verifikime e analizën financiare të kryer.

**28. Shuma 4.495 (katër mijë e katërqind e nëntëdhjetë e pesë) USD**, deklaruar në Deklaratën *Vetting* nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, z. P.G, si pagesë shkollimi për L.G (A.U in Bulgaria \*\*\*)).

**28.1** Subjekti i rivlerësimit, në pyetësorin standard datë 29.10.2021, ka deklaruar se ka kryer shpenzime për shkollimin e fëmijëve duke i shpjeguar ato në mënyrë të detajuar, si dhe ka përcjellë dokumentacion provues në lidhje me shpenzimet e kryera.

**28.2** Nga verifikimet e kryera në Komision, shpenzimet për arsimimin e fëmijëve janë kryer sipas dokumentacionit dhe analizuar sipas kontratave të përcjella, duke u përfshirë në analizën financiare, e cila ka rezultuar pozitive.

**28.3** Trupi gjykues çmon se pas verifikimeve të kryera dhe analizës financiare nuk janë konstatuar problematika në lidhje me detyrime/veprime financiare.

**29. Llogari rrjedhëse në Raiffeisen Bank**, në emër të vajzës L.G, në euro, nr. \*\*\*, nga kursimet e prindërve Ariana dhe P.G, në vlerën 1.920 (një mijë e nëntëqind e njëzet) euro. Pjesë takuese: 100%.

**29.1** Nga hetimi i kryer nga Komisioni, Raiffeisen Bank<sup>10</sup> konfirmon se L.G ka çelur llogari rrjedhëse pranë kësaj banke, aktive në periudhën 19.8.2016 – 31.12.2016<sup>11</sup>. Gjendja në këtë llogari në datën 21.10.2016 është në vlerën 1.316 (një mijë e treqind e gjashtëmbëdhjetë) euro.

**29.2** Lidhur me mundësitë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj për krijimin e kursimeve, të cilat kanë shërbyer si burim për krijimin e likuiditeteve, ato janë referuar në analizën financiare të kryer.

**29.3** Trupi gjykues çmon se pas verifikimeve të kryera dhe analizës financiare nuk janë konstatuar problematika në lidhje me këtë llogari bankare.

## **GJETJE TË TJERA**

**30.** Nga hetimi i Komisionit ka rezultuar se personi i lidhur, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, në datën 5.12.2014, ka trashëguar ¼ pjesë të të gjithë pasurisë trashëgimore të trashëgimlënësit, babait të tij L.N.G.

**30.1** Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se në DPV-në e vitit 2014, personi i lidhur P.G nuk e ka deklaruar këtë pasuri.

**30.2** Subjektit të rivlerësimit i janë kërkuar shpjegime lidhur me këtë konstatim, i cili në vijim ka parashtruar se: *“Referuar Kartelës së Pasurisë së Paluajtshme nr. pasurie \*\*\*, trashëguar 1/4 pjesë e të gjithë pasurisë trashëgimore të trashëgimlënësit, L.N.G (babai i bashkëshortit), trashëguar nga bashkëshorti, personi i lidhur P.G është regjistruar në datën 9.5.2019 në ZRPP, pasi babai i tij L.G, në gjalljen e tij, kishte lënë amanet që “kjo pasuri të posedohej dhe përdorej nga bashkëshortja F.G”. Për shkak të situatës së veçantë shëndetësore të “verbërisë diabetike”, u desh një kohë relativisht e gjatë për çeljen e trashëgimisë së të ndjerit L.G. Për shkak të këtyre rrethanave, dëshmia përkatëse e trashëgimisë dhe regjistrimi i saj janë bërë në datën 9.5.2019 dhe po për këtë arsye është deklaruar në ILDKPKI në deklaratën e radhës vjetore të vitit 2022, pas regjistrimit zyrtar në ZVRPP”.*

**30.3** Trupi gjykues, në vijim të shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, vëren se mosdeklarimi nga ana e subjektit nuk është i qëllimshëm e se pasuria rezulton plotësisht e ligjshme, duke e konsideruar këtë pasaktësi në deklaram irrelevante për procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin Ariana Gaçi.

## **31. Lidhur me adresat e banimit në Deklaratën Vetting**

**31.1** Subjekti i rivlerësimit deklaroi si adresë banimi:

a) të regjistruar në Zyrën e Gjendjes Civile: “Njësia Administrative Nr. \*\*\*, rruga “\*\*\*\*”, pallati \*\*\*, hyrja \*\*\*\*”;

b) si adresë tjetër vendqëndrimi: “Rruga \*\*\*, \*\*\*, kulla \*\*\*, nr. \*\*\*, Tiranë”.

**31.2** Gjatë hetimit, lidhur me adresat e banimit, ka rezultuar se:

**a) Për adresën e parë – rruga “\*\*\*\*” (ish-\*\*\*\*), pallati \*\*\* (ish-pallati \*\*\*\*), hyrja \*\*\* (ish-shkalla \*\*\*\*), apartamenti \*\*\* (ish-apartamenti \*\*\*\*), Njësia Administrative Nr. \*\*\*, Tiranë<sup>12</sup>:** Apartamenti është përfituar në datën 21.10.1993, kur është nënshkruar Kontratë Shitblerjeje me shitës Ndërmarrja Komunale Banesa nr. \*\*\* dhe blerës L.G, F.G, N.G e S.G për pasurinë apartament 2+1, me sip. 71.5 m<sup>2</sup>, nr. \*\*\*, kati \*\*\*, shkalla \*\*\*, pallati \*\*\*\*, rruga “\*\*\*\*”, Tiranë. Shpjeguar më lart në raport.

**b) Për adresën e dytë – Rruga \*\*\*, \*\*\*, kulla \*\*\*, nr. \*\*\*, Njësia Administrative Nr. \*\*\*, Tiranë.** Bazuar në verifikimin e kryer nga ILDKPKI-ja, ka rezultuar se Bashkia Tiranë<sup>13</sup>

<sup>10</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 14.2.2024, dosja e hetimit.

<sup>11</sup> Në këtë llogari në datën 19.8.2016 z. P.G ka depozituar *cash* shumën 1.920 euro, e cila tërhiqet në vijim nga e bija në periudha të ndryshme.

<sup>12</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 25.3.2024, dosja e hetimit.

<sup>13</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 4.8.2017, në dosjen e ILDKPKI-së.



konfirmon se shtetasi P.G ka të regjistruar në sistemin informatik pronë (zyrë), me sip. 7.70 m<sup>2</sup>, numër pasurie nuk ka, zona kadastrale nuk ka, në adresën: Rruga \*\*\*, me status “aktiv”, data e fillimit të detyrimeve 23.8.2007.

**31.3** Referuar dokumentacionit dhe deklarimeve të subjektit, në lidhje me këtë pronë (zyrë) rezulton se në adresën Rruga \*\*\*, \*\*\*, kulla \*\*\*, subjekti ka deklaruar në bashkëpronësi me shtetasin E.G apartamentin garsoniere me sip. 45 m<sup>2</sup>, ku ushtron aktivitetin “Avokat”, por sipërfaqja e deklaruar nga subjekti nuk përputhet me atë të dhënë nga Bashkia Tiranë.

**31.4** QKB-ja bën me dije Komisionin se nga verifikimi ka rezultuar se shtetasi P.L.G, datëlindja 3.7.1966, figuron i regjistruar si person fizik me NUIS \*\*\*, me status “aktiv”. Nga verifikimi i ekstraktit historik të regjistrimit tregtar të subjektit “P.G”, person fizik, rezulton se si adresë e ushtrimit të aktivitetit tregtar është regjistruar adresa: Rruga \*\*\*, Njësia Bashkiake Nr. \*\*\*, pallati “\*\*\*\*”, kulla \*\*\*, nr. \*\*\*, adresë e cila duket se i referohet një pasurie të re, në të njëjtën ndërtesë.

**31.5** Subjekti, e pyetur nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, deklaroi se nuk dispononte pasuri në përdorim apo posedim, përveç atyre të deklaruara në Deklaratën *Vetting*.

**31.6** Subjektit i janë kërkuar shpjegime nga Komisioni në vijim të konstatimeve për vendbanimin dhe problematikën lidhur me dy ambientet në adresën: Rruga \*\*\*, Njësia Bashkiake Nr. \*\*\*, pallati “\*\*\*\*”.

**31.7** Në vijim, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar: *“Kjo adresë është e njëjta me atë që kam deklaruar: Rruga \*\*\*, \*\*\*, kulla \*\*\*, nr. \*\*\*, Tiranë, nga ana e personit të lidhur, bashkëshortit tim P.G, është deklaruar si adresë e ushtrimit të aktivitetit tregtar, pra është e njëjta pasuri apartament garsoniere me sip. 45 m<sup>2</sup>, me adresë: Rruga \*\*\*, \*\*\*, kulla \*\*\*, nr. \*\*\*, Tiranë, vetëm se është bërë lapsus në deklarimin e sipërfaqes në organin tatimor nga ana e personit të lidhur. Gjatë kryerjes së detyrës si këshilltar ligjor në Gjykatën e Lartë, nga data 7.4.2014 deri më 13.10.2017, kam përdorur të dyja adresat”*.

**31.8** Në përfundim, trupi gjykues, pasi vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në raport me faktet dhe rrethanat, i konsideron ato të plota dhe bindëse duke mos konstatuar problematika për hetime/verifikime të mëtejshme.

**32.** Komisioni hetoi edhe lidhur me ekzistencën e kushteve të konfliktit të interesit<sup>14</sup> gjatë ushtrimit të detyrës prej subjektit të rivlerësimit në Gjykatën e Lartë dhe bashkëshortit të saj si përfaqësues i palëve në çështje gjyqësore të gjykuara pranë kësaj gjykate, gjatë kësaj periudhe, nga ku Gjykata e Lartë<sup>15</sup> informoi Komisionin se sipas Sistemit të Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore çështjet regjistrohen vetëm në emër të palëve ndërgjyqëse.

**32.1** Lidhur me sa më sipër, në vijim të pyetësorit të dërguar nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: *“Gjatë kryerjes së detyrës si ndihmës ligjor jomagjistrat në Gjykatën e Lartë nga data 7.4.2014 deri më 13.10.2017, bashkëshorti, av. P.G, ka marrë pjesë si avokat në dy çështje gjyqësore në Gjykatën e Lartë, për të cilat përcjell vendimmarrjet përkatëse”*.

**32.2** Në përfundim, nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti, trupi gjykues nuk evidentoi të dhëna lidhur me ekzistencën e konfliktit të interesit gjatë kryerjes së detyrës nga subjekti i rivlerësimit, si ndihmës ligjor në Gjykatën e Lartë.

**33.** Në pyetësorin standard, subjekti i rivlerësimit deklaroi se nga data 7.4.2014 bashkëshorti P.G ka marrë të ardhura të tjera, tërheqje shume në periudha të ndryshme, për llogari të tij nga depozita bankare e vëllait të tij E.G, përkatësisht në vlerat: 2.100 (dy mijë e njëqind) euro në vitin 2015 dhe 1.100 (njëmijë e njëqind) euro në vitin 2016. Kjo e drejtë i është dhënë nëpërmjet Prokurës së Posaçme nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 26.2.2015.

<sup>14</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 21.3.2024, në dosjen e hetimit.

<sup>15</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 9.4.2024.

**33.1** Gjatë hetimit ka rezultuar se nga personi i lidhur P.G janë kryer veprime tërheqjeje nga llogaria bankare e të vëllait E.G në shumën 2.100 (dy mijë e njëqind) euro në vitin 2015 dhe 1.100 (njëmijë e njëqind) euro në vitin 2016, të cilat nuk janë deklaruar asnjëherë si të ardhura në deklaratimet periodike vjetore dhe as në Deklaratën *Vetting*.

**33.2** Subjektit të rivlerësimit i janë kërkuar shpjegime<sup>16</sup> nga Komisioni lidhur me qëllimin e këtyre të ardhurave të tërhequra në periudha të ndryshme nga z. P.G prej depozitës bankare të të vëllait.

**33.3** Në vijim, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se bashkëshorti P.G ka autorizim me Prokurën e Posaçme nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 26.2.2015, të lëshuar nga vëllai i tij E.G, për ta ndihmuar atë në kryerjen e veprimeve bankare në Republikën e Shqipërisë, për pagesa dhe likuiditete të ndryshme me porosi dhe miratimin e tij, pasi ai ndodhej me punë jashtë Shqipërisë, si dhe për shkak të situatës së veçantë të nënës së bashkëshortit P.G, znj. F.G.

**33.4** Trupi gjykues vlerëson se nuk rezultuan problematika lidhur me këtë deklaram, si dhe nuk vëren indicie apo rrethana për hetime të mëtejshme, në interes të procesit të rivlerësimit kalimtar.

**34.** Analiza financiare e kryer nga Komisioni për subjektin e rivlerësimit ka rezultuar me balancë pozitive.

**35.** Nga hetimi nuk kanë rezultuar të dhëna apo *indicie* për pasuri të tjera të subjektit të rivlerësimit apo personave të lidhur me të, të padeklaruara prej tij.

#### **Konkluzione për rubrikën e vlerësimit të pasurisë**

**36.** Në përfundim, trupi gjykues në lidhje me rubrikën e vlerësimit të pasurisë arrin në përfundimin se nga kontrolli i pasurisë ndaj subjektit të rivlerësimit nuk u evidentuan pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, se ai ka kryer deklaram që është i saktë dhe në përputhje me ligjin dhe ka pasur burime financiare të ligjshme e të mjaftueshme. Pasuria e subjektit të rivlerësimit dhe e personave të lidhur rezulton të jetë e ligjshme, nuk ka deklarim të rremë apo të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë. Subjekti nuk gjendet në situatë konflikti interesi.

## **B. KONTROLLI I FIGURËS**

**37.** Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarameve dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Në përfundim, ky institucion, në datën 21.12.2017, ka dërguar raportin mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit Ariana Xh. Gaçi, duke konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e ushtrimit të detyrës.

**38.** Komisioni i ka kërkuar institucioneve ligjzbatuese sipas ligjit, përditësim të informacionit mbi të dhëna shtesë për subjektin e rivlerësimit Ariana Xh. Gaçi, për sa kohë që raporti mbi kontrollin e figurës ishte deri më 21.12.2017. Nga verifikimet nuk kanë rezultuar të dhëna për hetime të mëtejshme.

**39.** Komisioni ka kërkuar nga AKSIK-ja deklasifikimin e raportit për vlerësimin e figurës për subjektin e rivlerësimit Ariana Xh. Gaçi, i cili, në vijim, ka përcjellë raportin mbi kontrollin e figurës për këtë subjekt rivlerësim, të deklasifikuar plotësisht, duke konstatuar përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës.

<sup>16</sup> Pyetësori nr. 2, kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 3.4.2024.

40. Gjatë procesit të hetimit administrativ Komisioni nuk konstatoi asnjë problematikë lidhur me pastërtinë e figurës për subjektin e rivlerësimit Ariana Gaçi.

### **Konkluzione për rubrikën e vlerësimit të figurës**

41. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi dokumentacionin e dorëzuar prej subjektit të rivlerësimit, deklaratën për kontrollin e figurës, raportin e AKSIK-së dhe informacionet nga organet ligjzbatuese, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklarimit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi. Nuk u provua që subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo që të jetë i përfshirë, apo i vënë nën presion nga persona të përfshirë në krimin e organizuar, si rrjedhojë, e gjen atë të përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.

### **C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE**

42. Vlerësimi i aftësive profesionale të ndihmësve ligjorë pranë Gjykatës së Lartë kryhet në përputhje me parashikimin e nenit 42, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, si dhe bazuar edhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

43. Raporti i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit Ariana Gaçi është hartuar mbi bazën e raportit të vlerësimit të përgatitur nga KLGJ-ja, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, duke iu referuar kriterëve të vlerësimit, në përshkrimin dhe analizimin e: 3 dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit; 5 dokumenteve ligjore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; të dhënave të përcjella nga Gjykata e Lartë; si dhe rezultateve të testimi pranë Shkollës së Magjistraturës.

44. Nga përmbajtja e tetë dokumenteve ligjore konstatohet se në çdo rast ndihmësja ligjore ka studiuar çështjen gjyqësore dhe e ka relatuar për çdo shkallë gjykimi, duke identifikuar disponimet e gjykatave më të ulëta, thelbin e analizës ligjore, si dhe shkaqet e rekursit. Këto veprime ajo i ka materializuar në relacionin ligjor, ku ka plotësuar elementet procedurale të kërkuara në nenin 21 të ligjit nr. 8588, datë 15.3.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe nenin 25 të Rregullores së Brendshme të Gjykatës së Lartë, miratuar me urdhrin nr. 214, datë 12.9.2014, të Kryetarit të kësaj Gjykate.

45. Në lidhje me njohuritë ligjore të zotëruara nga znj. Ariana Gaçi, të konstatuara nga tetë dokumentet ligjore të vlerësuara, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit, si dhe dokumentet shoqëruese të paraqitura prej saj, konkludohet se subjekti i rivlerësimit në relacionet/mendimet ligjore të hartuara prej saj manifeston njohuritë e duhura ligjore për të prezantuar saktë çështjen objekt gjykimi, duke identifikuar drejt legjislacionin e zbatueshëm e duke dhënë edhe orientimin për zgjidhjen konkrete të çështjes nga gjykata.

46. Në tetë dokumentet ligjore të analizuara ka rezultuar se mendimi i ndihmësit ligjor përputhet plotësisht me vendimmarrjen e Gjykatës së Lartë. Në dokumentet ligjore evidentohet përdorimi i parimeve të përgjithshme të së drejtës, analizë apo referim në jurisprudencën përkatëse në rastet e relatuara.

### **REZULTATET E TESTIMIT PRANË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS**

47. Shkolla e Magjistraturës ka përcjellë<sup>17</sup> pranë Komisionit rezultatet e testimi të aftësive profesionale për subjektet e rivlerësimit *ex officio*, të parashikuar në pikën 4 të nenit 179/b<sup>18</sup> të Kushtetutës dhe pikën 2 të nenit 42<sup>19</sup> të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

<sup>17</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 23.5.2018.

<sup>18</sup> Të gjithë këshilltarët ligjorë pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, ndihmësit ligjorë pranë gjykatave administrative, ndihmësit ligjorë pranë Prokurorisë të Përgjithshme do të rivlerësohen *ex officio*.

<sup>19</sup> Këshilltari ligjor i Gjykatës Kushtetuese, ndihmësi ligjor i Gjykatës së Lartë, Gjykatës Administrative, si dhe ndihmësi ligjor në Prokurorinë e Përgjithshme, të cilët nuk janë magjistratë, vlerësohen bazuar në: a) relacionet dhe mendimet ligjore të përgatitura; b) rezultatet e testimi pranë Shkollës së Magjistraturës.

**48.** Në testimin profesional të organizuar nga Shkolla e Magjistraturës rezulton se ndihmësja ligjore e Gjykatës së Lartë Ariana Gaçi është vlerësuar në fazën e parë me 42 pikë nga 100 pikë maksimale dhe në fazën e dytë me 121 pikë nga 200 pikë maksimale, në total 163 pikë.

**49.** Bazuar në parashikimet e nenit 165/4<sup>20</sup> të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, subjekti i rivlerësimit nuk bën pjesë të subjektet që kanë fituar të paktën 60% të pikëve të testimit të aftësive profesionale e, për pasojë, nuk është kualifikuar për të ndjekur formimin fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës.

**50.** Duke qenë se testimi pranë Shkollës së Magjistraturës është në vetvete një nga kriteret e vlerësimit të aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit *ex officio*, Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit është vlerësuar me një rezultat mbi mesataren në fazën e testit profesional, i cili do të shërbejë për vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit në mënyrë kumulative, sipas ligjit nr. 84/2016.

**51.** Nga verifikimi i regjistrimit të denoncimeve nuk rezulton që të jenë depozituar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit ankesa apo denoncime nga publiku për subjektin e rivlerësimit Ariana Gaçi, në kuptim të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**52.** Në kuadër të hetimit administrativ, Komisioni ka kërkuar informacion edhe lidhur me procedime në ngarkim të subjektit të rivlerësimit Ariana Gaçi, nga ku ka rezultuar se pas verifikimeve në regjistrin e njoftimit të veprave penale të Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar në datën 11.12.2020 është regjistruar procedimi penal nr. \*\*\* për veprën penale të parashikuar nga nenet 248 dhe 25 të Kodit Penal, në ngarkim të shtetasës Ariana Gaçi etj.

**52.1** Pas përfundimit të hetimeve në lidhje me këtë procedim penal, në datën 28.7.2022, nga prokurori i çështjes është hartuar kërkesa për dërgimin për gjykim të këtij procedimi penal, për veprën penale të parashikuar nga nenet 248 dhe 25 të Kodit Penal.

**52.2** Me vendimin nr. \*\*\*, datë 6.11.2023, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë Për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka vendosur deklarimin të pafajshëm të të pandehurës Ariana Gaçi për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, kryer në bashkëpunim.

**52.3** Kundër këtij vendimi është ushtruar ankim në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, nga ku nuk rezulton të ketë një vendimarrje përfundimtare.

**53.** Në vijim të rrethanave të shpjeguara më sipër, Komisioni, bazuar në parimin e drejtësisë, paanësisë dhe objektivitetit, çmon se çështja e trajtuar më sipër nuk do të merret në konsideratë për vlerësimin e subjektit, në kuptim të procesit të rivlerësimit të saj kalimtar.

### **Vlerësim i kriterit të aftësive profesionale**

**54.** Bazuar në ligjin nr. 84/2016, duke qenë se testimi pranë Shkollës së Magjistraturës së bashku me relacionet dhe mendimet ligjore të përgatitura shërbejnë në mënyrë kumulative për vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, nga analiza në tërësi e kriterit të aftësive profesionale, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në ushtrimin e detyrës dhe është efiçente dhe efektive në masë të pranueshme, duke arritur nivelin kualifikues të kërkuar nga neni 59 i ligjit nr. 84/2016, në vlerësimin e aftësive profesionale.

<sup>20</sup> Subjektet e parashikuara në pikat 1 dhe 3 të këtij neni, të cilët kanë arritur të paktën 60 % të pikëve të testit të aftësive profesionale në Shkollën e Magjistraturës, sipas parashikimeve të ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, kanë të drejtë: a) të ndjekin programin teorik njëvjeçar të Shkollës së Magjistraturës; b) të caktohen brenda afatit 1-mujor pas përfundimit të programit të trajnimit për një vit për të kryer praktikë profesionale në gjykata ose prokurori të ndryshme, duke zbatuar parashikimet e nenit 33 të këtij ligji, për aq sa gjejnë zbatim; c) të përfitojnë gjatë periudhës dyvjeçare të trajnimit të parashikuar në shkronjat “a” dhe “b” të kësaj pike, respektivisht pagë të barabartë me pagën e ndihmësit ligjor, inspektorit ose këshilltarit të gjyqtarit.

**55.** Në përmbushje të parashikimit të shkronjës “a” të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, si dhe në zbatim të nenit 59, pika 1, shkronja “c”, trupi gjykues e konsideron subjektin e rivlerësimit “të aftë” në kryerjen e funksionit të këshilltarit/ndihmësit ligjor.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 58 dhe pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi konstatoi se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe një nivel të mirë të vlerësimit të aftësive profesionale,

### **V E N D O S I:**

- 1.** Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Ariana Gaçi, ndihmëse ligjore në Gjykatën e Lartë.
- 2.** Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
- 3.** Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik dhe/ose subjekti i rivlerësimit 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit.
- 4.** Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.  
U shpall në Tiranë, në datën 5.6.2024.

### **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Alma FASKAJ**  
**Kryesuese**

**Valbona SANXHAKTARI**  
**Relatore**

**Pamela QIRKO**  
**Anëtare**

*Sekretare gjyqësore*  
*Mevi Dibra*